



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Zyra për Informim



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES/KABINET PREDILOŽIA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2789 Nr. i faq./Br.sht./No pg 50
Data/Datum/Date 5 / 10 2022
RAHOVEC / ORAHOVAC

Data/Date:	5.10.2022
Nga/Od/From	Grupi punues
Për/Za/To:	Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
CC	Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Rahovecit, Defrim Kafexhiu
Tema/Subjekat/Subject	Raporti për konsultimin publik për Planin e Trashëgimisë Kulturore 2022-2024

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Ecuria e procesit të konsultimit publik për Planin e Trashëgimisë Kulturore 2022-2024

Kryetari i Komunës, më 1 gusht ka marrë vendim për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Planit e Trashëgimisë Kulturore 2022-2024, në këtë përbërje:

1. Afrim Dina -kryesuese
2. Qemajl Krasniqi -anëtar
3. Saranda Shala - anëtar
4. Muharem Morina-anëtar
5. Irfan Ramadani- anëtar
6. Zaim Kryeziu, anëtar
7. Miftar Kryeziu, anëtar
8. Blerta Gashi, anëtare
9. Albulena Rexhaj, anëtare
10. Shadat Ukaj, anëtar

Grupi punues ka për detyrë që të bëj hartimin e Planit e Trashëgimisë Kulturore 2022-2024 në komunën e Rahovecit.

Bazuar në vendimin e kryetarit, grupi punues ka mbajtur disa takime rreshtazi, duke bërë hartimin e Planit e Trashëgimisë Kulturore 2022-2024 në komunën e Rahovecit.

Plani i Trashëgimisë Kulturore 2022-2024 u vu në konsultim publik më 19 gusht 2022 deri më 19 shtator 2022 ashtu siç parasheh Udhëzimi për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike ndërsa konsultimi publik u parapa të mbahej më 2 shtator 2022, mirëpo për shkak të hapjes zyrtare të festivalit Hardh Fest u mbajt më 6 shtator 2022.

Njoftimi: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/> (nuk ka qasje uebi për me bart linkun)

Platforma Qeveritare për Konsultime Publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41505>

Konsultimi Publik

Konsultimi Publik për Planin e Trashëgimisë Kulturore 2022-2024 u mbajtë më: 6.9.2022 në Sallen e Kuvendit Komunal Rahovec, me fillim nga ora 10:00

Metodat e konsultimit	Data/ Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa/ sugjerime
1. Takim i drejtpërdrejtë në Sallën e Kuvendit me pjesëmarrës nga lagjet urbane dhe këshillat e fshatrave si dhe me përfaqësues të OJQ-ve veprojnë në komunën e Rahovecit	6.9.2022 1 orë	15 pjesëmarrës 4 femra	6 pjesëmarrës kanë parashtruar pyetje
Publikimi në ueb faqe / platforma elektronike	14 ditë para dëgjimit publik		Asnjë koment nuk kemi marrë

Shtojca 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Statusi i kërkesës/ sugjerimit (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komentëve është i detyrueshëm)
Muhamet Ramadani- <i>Celinë- Përsëndetje, ne si fshat kemi disa pika të trashëgimisë kulturore, kemi Kronin e Fshatit me mbi 200 vite, I cili deri tash nuk u mbikëqyr, Pisjaku- mal afër 8 hektar, mal shumë I vjetër, Bunar I Vuçitërnës, I cili gjendet mes fshtait Fortesë dhe Celinë, I cili nuk është në gjendje të mirë, Xhamia e Fshatit prej 1921, Lis I Shpirtit, në të cilin banorët gjenjnë shërim shpirtëror, kemi edhe Shtëpinë Muze të varrezat e fshatit, Teqeja e Dervish Sokolit, mbi 45 vite u rregullu, po që ka nevojë me u mbikëqyr.</i>	E pranuar	Grupi punues për Planin e Trashëgimisë Kulturore, pas pyetjes që ka bërë përfaqësuesi i Këshillit të fshatit Celinë z. Muhamet Ramadani, e ka konsideruar si të vlefshëm propozimin e tij dhe pas konsultimeve i ka përfshirë të gjitha propozimet në Planin e Trashëgimisë Kulturore.
Muharrem Morina- <i>po flas në cilësinë e fshtait Dejn. Desha mu ndërlidh me lokalitetin në Çifllak, aty ku janë bërë zbulime arkeologjike, që I përkasin peridhës romake dhe në Kramovik aty ku</i>	E pranuar	Studimet arkeologjike të kryera në zonën arkeologjike të fshatit Çifllak gjetën të dhëna për ekzistencën e një vendbanimi i cili i takonte fillimit të mijëvjeçarit të parë. Hulumtimet e mëtutjeshme rezultuan me zbulimin e mbetjeve të një kompleksi banjosh (termash) romake, me dimensione të gjera, mes të cilave është dokumentuar edhe

<i>është gjetur përkrenarja ilire, e cila u shkatërroi, por, unë kisha propozu që të futen në listën e trashëgimisë kulturore.</i>		ku një pishinë. Materiali arkeologjik i zbuluar në këtë lokacion tregon prodhimin lokal të enëve prej balte si dhe asosh të importuara të njohura si terra sigillata. Përveç mjeteve metalike, monedha, kavanoza qelqi dhe struktura arkitektonike, edhe objekte të ndryshme për përdorim të përditshëm janë zbuluar në këtë vend. Prandaj ne si grup punues i Planit për Trashëgimi Kulturore e ka përfshirë në planin për Trashëgimi Kulturore.
Binak Berisha- <i>Kramovik-Ne si familje kemi pas një kullë të vjetër e cila u rrënu, ne kemi pritur për institucionet e Kosovës, por, ata nuk aknë ndërmarrë asgjë më restaurimin e saj, andaj, pronari i saj ka vendosur ta rrënoj në pamundësi që të ndërmarrë diçka dhe për sigurinë e familjes së tij, andaj, unë desha të pyes që a ka mundësi të bëhej diçka në këtë drejtim rreth kësaj Kulle, sepse ka foto ka video në youtube. Poashtu desha të ndërlidhen edhe rreth përkrenares, edhe pse ata që kanë gjetur nuk ekanë bërë publike por, mire do të kishte qenë që si institucion të ndërmerrni edhe diçka rreth futjes në listën e trashëgimisë kulturore.</i>	E pranuar pjesërisht	Duke e marrë parasysh që disa nga objektet e trashëgimisë Kulturore në fshatin Kramovik janë shkatërruar grupi punues për Trashëgimi Kulturore ka pranuar pjesërisht kërkesat dhe ka përfshi një pjesë të tyre në Planin e Trashëgimisë Kulturore.

Fatmir Sejfullahu- <i>Desha me u ndërlidh rreth shtëpive muze, ku po I vendosni pllakat, ato shtëpi një pjesë e tyre janë rrënuar, ose janë shndërruar në kafiteri, kam një vëretje sepse nuk ka më gjurmë aty. Komuna dhe shteti po reagojnë me vonesë, mos me I leju me I prish me I humb gjurmët.</i>	E pranuar	Ne si grup punues, në koordinim me ekzekutivin dhe me OVL e UÇK-së do të paraqesim këtë shqetësim tuajin dhe do të mundohejmë tu dalim në mbrojtje objekteve që përfaqësojnë vlera kulturore, historike dhe trashëgimi kulturore.
Binak Berisha-Pikat dhe istikamet ku UÇK-ja ka kry aksione. Ne në Kramovik kemi një pikë ku me 14 qershor kur është sulmuar posti famëkeq I Kramovikut dhe aty janë disa istikame të gjitha të lëna në fatin e kohës duke u degraduar. Andaj, kisha kërkuar që bashkëfinancim me banorët të bëjmë përpyetje për ti restauruar dhe për t'i mbrojtur dhe të mos humbin	E pranuar pjesërisht	Duke e marrë parasysh që disa nga objektet e trashëgimisë Kulturore në fshatin Kramovik janë shkatërruar grupi punues për Trashëgimi Kulturore ka pranuar pjesërisht kërkesat dhe ka përfshi një pjesë të tyre në Planin e Trashëgimisë Kulturore.

Dervish Qadraku: Të mbrohen dhe standardizohen vlerat e luftës së UÇK-së!	E pranuar	Vlera e UÇK-së, është sinonim i vlerës së lirisë së Kosovës, që është vulosur me gjakun e heronjve, dëshmorëve dhe me sakrificën e popullit tonë liridashës. Vlerë e lirisë që është vulosur me numrin e viktimave të luftës, me fëmijët, gratë dhe pleqtë e pafajshëm të vrarë e të masakruar. Vlerë e lirisë që është vulosur me numrin e personave të zhdukur, me numrin e grave të dhunuara dhe me gjenocidin e paparë që ka ushtruar regjimi serb në Kosovë. Vlerë që është vulosur me shtëpitë e djegura dhe të rrënuara, me vjedhjet, shkatërrimin e pronës, pasurisë dhe gjithçka që ishte e jona. Është vlerë e dhimbjes dhe vuajtjeve. Prandaj grupi punues për Trashëgimi Kulturore ka pranuar kërkesën dhe ka futur në Planin e Trashëgimisë Kulturore .
---	------------------	---

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Vendimi për caktimin e grupit punues për hartimin e Planin e Trashëgimisë Kulturore
2. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik
3. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik
4. Lista e zyrtarëve pjesëmarrës në konsultimin publik

Rahovec, tetor 2022

Blerta Gashi



Zyrtare për Informim





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I LIRYET VUT TE DOMBRESA/ABNET PRESIEDILA OPŠTINE, MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunesë)
Nr./Br./No 2612 Nr. i fag/Br str/No pa 32
Data/Datum/Date 19.8.22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Komuna e Rahovecit përmes grupit punues për hartimin e Draft Planit Komunal për Trashëgimi Kulturorë 2022-2024, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.3.2017 dhe Nenit 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, lëshon këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me konsultimin publik për Draft Planin Komunal për Trashëgimi Kulturorë 2022-2024

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga 19.8.2022 deri me datën: 19.9.2022, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me 2.9.2022, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit e cila gjendet në objektin e ri të administratës komunale, me fillim në ora 10:00.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri me datën 18.9.2022 në ora 16:00, tek zyrtarët: afirm.dina@rks-gov.net, muharem.a.morina@rks-gov.net, Blerta.Gashi@rks-gov.net; dhe Skender.Hamza@rks-gov.net

Për më shumë detaje, rreth Draft Planin Komunal për Trashëgimi Kulturorë 2022-2024, mund të gjeni në vegëzat e mëposhtme:

Uebfaqe zyrtare: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/konsultime-publike-al/dokumente-ne-konsultim-publik/>

Platforma për Konsultime Publike: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/konsultime-publike-al/dokumente-ne-konsultim-publik/>

Facebook: <https://www.facebook.com/rahoveckomuna>

Blerta Gashi

Zyrtar për Informim





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – President of the Municipality Mayor

Njësia Nr./Br./No (Udhëheqësi i Kryetari të Komunës)

Nr./Br./N 2524 Nr. ifaq/Br.shr./No.pz 24

Data/Datum/Date 1 8 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Planit për Trashëgimi Kulturor në Komunën e Rahovecit

1. Caktohet Grupi Punues për hartimin e Planit për Trashëgimi Kulturor në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1 Afrim Dina, kryesues
 - 1.2 Qemajl Krasniqi, anëtar
 - 1.3 Saranda Shala, anëtare
 - 1.4 Muharem Morina, anëtar
 - 1.5 Irfan Ramadani, anëtar
 - 1.6 Skender Krasniqi, anëtar
 - 1.7 Zaim Kryeziu, anëtar
 - 1.8 Miftar Kryeziu, anëtar
 - 1.9 Blerta Gashi, anëtare
 - 1.10 Albulena Rexha, anëtare
 - 1.11 Shedal Ukaj, anëtar
2. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Planin për Trashëgimi Kulturor në Komunën e Rahovecit.
3. Obligohet Grupi Punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Grupi Punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Obligohet Grupi punues që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e grupit punues për hartimin e Planit për Trashëgimi Kulturor në Komunën e Rahovecit.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Lista e nënshkrimëve e qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik për Planin e Trashëgimisë Kulturore

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi-Institucioni	Nr. Tel	Nënshkrimi
1	Fetimin	Sejfullahu	Krujë Madhe	046	[Signature]
2	BAJRAM	MORINA	DEJNË	04	[Signature]
3	Dervish	Qadriaku	Mulës, e Vogël	049	[Signature]
4	Vjollca	Gurgule	SHL "Korob"	049	[Signature]
5	KINDITA	SIMITSIU	PZ-SHL "Koi"	04	[Signature]
6	Admir	Mullakoshi	Rahovec	04	[Signature]
7	Muhamet	Ramadani	Celinë	04	[Signature]
8	Mehrem	Krasniqi	SHL "Kosova"	04	[Signature]
9	Pranver	Abazibaj	Rahovec	04	[Signature]
10					
11					
12					
13					
14					
15					
16					
17					
18					
19					
20					

Përgatiti:

Nënshkrimi:

Data: 6.9.2022



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Lista e nënshkrimeve të zyrtarëve pjesëmarrës në konsultimin publik për Planin e Trashëgimisë Kulturore

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita	Nr. Tel	Nënshkrimi
1	QEMAJL	KRASNIQI	DKRS	044	
2	Blerita	Gashi	ZIP	044	
3	Muharrem	Heine	DKRS	044	
4	IRFAN	RAHADANI	DKRS	04	
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					

Përgatiti: Blerita Gashi

Nënshkrimi:

Data: 6.9.2022